




NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

Mars 2022



RESPUBLICA



Transparenca është e thjeshtë, deri sa autoritetet e komplikojnë “për mirë”

E DREJTA E INFORMIMIT 2021

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e National Endowment for Democracy.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës Res Publica dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet se reflekton opinionin e National Endowment for Democracy.

Autorë:

Av. Dorian Matlija
Dr. Irena Dule

Botues: Qendra “Res Publica”
Redaktor: Dorian Matlija
Tirazhi: 200 kopje
Layout & Print: Expo Vision Albania

© Res Publica 2022

Transparenca është e thjeshtë, deri sa autoritetet e komplikojnë “për mirë”

E DREJTA E INFORMIMIT 2021

PERMBAJTJA

5 Hyrje

7 Metodologjia

9 Vlerësimi i punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit

10 Numri i ankesave drejtuar Komisionerit

10 Subjektet që i janë drejtuar Komisionerit

11 Numri i vendimeve të marra nga Komisioneri

12 Llojet e vendimeve

13 Kohëzgjatja e marrjes së vendimeve nga Komisioneri

14 Aplikimi i sanksioneve

17 Transparenca e Institucioneve

17 Reagimi i institucioneve ndaj kërkesave për informacion

21 Vlerësimi i transparencës proaktive

25 Çështje me interes të veçantë për të drejtën e informimit, gjatë vitit 2021

25 Agjencia e Medias dhe Informimit, një krijesë sui generis që ndërhyr në të drejtën për informim

27 Diskutime mbi draftin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

27 Konventa e Tromsos

28 Tarifa e dhënies së informacionit, “dogana” që duhet kaluar për marrjen e informacionit

30 Akses i gazetarëve në informacion rreth proceseve gjyqësore dhe roli i gjyqtarit të medias

33 Të dhëna nga platforma “Publeaks.al”

34 Përdorimi i faqes Publeaks.al

34 Aplikantët sipas grupmoshave

35 Aplikantët sipas arsimimit

34 Aplikantët sipas gjinisë

37 Konkluzione

38 Për sa i përket reagimit ndaj kërkesave për informacion

38 Për sa i përket programeve të transparencës

39 Për sa i përket infrastrukturës së zbatimit të ligjit

39 Për sa i përket veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit

40 Për sa i përket çështjeve të veçanta

41 Për sa i përket interesit të qytetarëve për të përdorur të drejtën e informimit

43 Rekomandime

1. HYRJJE

Ky raport u përgatit nga Qendra Res Publica, me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED), në kuadër të projektit “Promovimi i lirisë së shprehjes dhe të të drejtës së informimit në Shqipëri”.

Viti 2021 është viti i shtatë rradhazi që Res Publica monitoron zbatimin e ligjit, duke pasur në fokus nga njëra anë interesin e qytetarëve për të përdorur të drejtën për t’u informuar dhe nga ana tjetër sjelljen e institucioneve publike për garantimin dhe respektimin e të drejtës së qytetarëve për t’u informuar.

Res Publica, si një nga organizatat më aktive në fushën e të drejtës së informimit, edhe gjatë këtij viti është përpjekur ta verë në provë efektivitetin e ligjit, duke testuar në mënyrë aktive, me fokus të veçantë aty ku perceptohet se ka më shumë dobësi, të cilat përbëjnë shteg për zyrtarët që nuk dëshirojnë të japin informacionin e kërkuar.

Në këtë raport trajtohen edhe dy çështje me rëndësi të ndodhura gjatë vitit 2021. Njëra prej ngjarjeve është hartimi i një projektligji nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin për të drejtën e informimit, për të cilin pritet të zhvillohet një seri konsultimesh publike. Ngjarja tjetër është krijimi i Agjencisë për Median dhe Informimin, e cila është një agjenci e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, që synon të rregullojë marrëdhënien gazetar - institucion publik, dhe ku një aspekt që trajtohet është edhe informimi i gazetarëve nga institucionet publike.

Gjithashtu raporti paraqet edhe disa rezultate që dalin nga përpunimi i të dhënave të marra nga platforma Publeaks.al gjatë tre viteve të fundit. Platforma publeaks.al u krijua nga Res Publica në dhjetor 2016 për t’i ardhur në ndihmë gazetarëve, studiuesve, qytetarëve aktivë, që dëshirojnë të informohen për çështje të ndryshme të veprimtarisë shtetërore, duke lehtësuar aksesin e tyre në informacionin publik. Aplikuesi në këtë portal mjafton të shfaqë kuriozitet për një çështje të caktuar, pa pasur nevojë të ketë dijeni se kujt duhet t’i drejtohet pyetja apo si duhet formuluar kërkesa. Stafi që menaxhon platformën përgatit pyetjen në formën

e duhur, duke i kushtuar rëndësi formulimit sa më konkret të kërkesës për të mos pasur vend për paqartësi nga ana e institucioneve publike që u drejtohet kërkesa. Më pas stafi ndjek të gjitha procedurat, duke përfshirë ankimet administrative dhe gjyqësore, deri në marrjen e plotë të informacionit. Pasurimi i platformës e shndërron atë në një arkivë me një shumëllojshmëri informacionesh, të cilat janë siguruar më parë nga aplikimet në platformë dhe janë të aksesueshme nga publiku në çdo kohë.

Në vlerësimin tonë, raporte periodikë të këtij lloji i shërbejnë më mirë publikut dhe mirëqeverisjes kur ato paraqesin dukuri problematike, të cilat nuk janë të dukshme në pamje të parë, në vend të dhënies së një tabloje të ftohtë me vlerësime të dhënash, që edhe pse lidhen me efektivitetin e ligjit, jo domosdoshmërisht e rrisin transparencën. Për këtë arsye në përfundim jepen edhe rekomandime konkrete në shërbim të qëllimit për një qeverisje më transparente dhe për ndërgjegjësimin dhe motivimin e qytetarëve për përdorimin e të drejtës së informimit.

Autorë: Av. Dorian Matlija
Dr. Irena Dule

Ndihmuan: Esmeralda Hoxha
Brunilda Qershori

2. METODOLOGJIA

Si një vazhdimësi e raporteve të përvitshme, duke nisur që prej vitit 2015, edhe ky raport ka për qëllim paraqitjen e të dhënave të mbledhura nga monitorimi i zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, gjatë vitit 2021. Gjetjet janë krahasuar me ato të viteve të shkuara, duke ruajtur të njëjtën metodologji për sa ka qenë e mundur. Falë krijimit të platformës Publeaks.al në fund të vitit 2016 është bërë e mundur dhe mbledhja e të dhënave më specifike, posaçërisht për të lehtësuar aksesin në informacionin publik.

Raporti është bazuar nga të dhënat e mbledhura si më poshtë:

Së pari, është monitoruar veprimtaria e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, si autoriteti i krijuar posaçërisht nga ligji për të garantuar funksionimin e tij. Njëlloj si në raportet e viteve të kaluara, veprimtaria e Komisionerit është parë në një këndvështrim kritik sepse relaksimi i kësaj zyre në raport me shkeljet mund të sjellë pasoja afatgjata në formimin e zakoneve që minojnë qëllimin e ligjvënësit dhe cenojnë një të drejtë kushtetuese me rëndësi parësore në një shoqëri demokratike. Përmes informacioneve që burojnë nga zyra e Komisionerit, janë paraqitur të dhëna për numrin e ankesave, mënyrës së trajtimit të tyre, vendimet e marra, sanksionet e vendosura, etj. Gjithashtu një vemendje e veçantë i është kushtuar projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”” i hartuar nga Komisioneri përgjatë vitit 2021.

Së dyti, është testuar dhe vlerësuar reagimi i institucioneve, duke vlerësuar përmes kriterëve të matshme sjelljen e tyre ndaj kërkesave për informacion. Më konkretisht janë dërguar 167 kërkesa për informacion dhe është monitoruar i gjithë procesi administrativ i tyre. Kërkesat kanë nisur kryesisht përmes aplikimit në faqen Publeaks.al.

Së treti, është monitoruar “transparenca proaktive” e institucioneve publike, duke vlerësuar programet e transparencës në të cilat publikohen informacionet pa nevojën e një kërkesë nga ana e publikut. Kështu janë vlerësuar plotësimi, përshtatja dhe përditësimi i programeve të transparencës. Më konkretisht janë përzgjedhur për monitorim 100 autoritete publike me rëndësi më të madhe, duke marrë kampione me nga 20 institucione, në 5 kategoritë kryesore: institucione kushtetuese dhe të pavarura; (2) institucione qendrore të pushtetit ekzekutiv;

(3) institucione të vartësisë të pushtetit ekzekutiv; (4) institucione të pushtetit vendor; (5) institucione të pushtetit gjyqësor. Monitorimi është fokusuar në përmbushjen e të gjithë elementëve që duhet të përmbajë një program transparence, duke i dhënë rëndësi atyre elementëve që lidhen me informacione të vlefshme dhe përgjithësisht sensitive dhe duke i dhënë një rëndësi më të vogël informacioneve të tjera.

Së katërti, është monitoruar ngritja e kapaciteteve të nevojshme që çdo institucion të bëjë të mundur funksionimin e detyrimeve në drejtim të informimit, me të cilat e ngarkon ligji. Në këtë kuptim është monitoruar caktimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit, si dhe publikimi dhe përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.

Nga 167 kërkesa janë përzgjedhur 157 prej tyre, të cilat kanë ndjekur ciklin e plotë, duke ruajtur një numër të përshtatshëm për efekt krahasimi me vitet e mëparshme. Disa nga treguesit kryesorë të matshëm që janë marrë në konsideratë janë: (1) Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes; (2) Plotësia dhe saktësia e përgjigjes; (3) Reagimi i institucioneve pas ankimit administrativ.

Së pesti, është studiuar projektligji për disa ndryshime në ligjin nr 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" me qëllim përfshirjen në konsultimin publik që do të zhillohet për këtë qëllim, me rekomandimet përkatëse.

Së gjashti, raporti trajton problematikën e shkaktuar me krijimin e Agjencisë për Media dhe Informim, e ashtuquajtur Agjencia e Propagandës, në aspekt të së drejtës së informimit.

Së shtati, pjesë e këtij monitorimi është edhe dedikimi i stafit të qendrës Res Publica në litigime dhe evidentimin e problematikave të mbartura nga vitet e kaluara të cilat janë ende të pazgjidhura.

Së fundi, nga të dhënat e mbledhura nga aplikimet në Publeaks.al, edhe pse nuk përbën qëllim parësor të këtij raporti, janë parë me interes edhe aspekte që kanë të bëjnë me motivimin e qytetarëve për t'u informuar, të tilla si mosha e aplikantëve, arsimimi, gjinia, kategoria, objekti i kërkesave, etj.

3. VLERËSIMI I PUNËS SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucioni që kujdeset për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit.


Ndonëse Komisioneri ka ndërmarrë vazhdimisht nisma për të trajnuar nëpunësit e administratës për detyrimet që rrjedhin nga ligji për të drejtën e informimit, si dhe ka krijuar një praktikë të gjerë me afro 300 vendime që interpretojnë aspekte të ndryshme të ligjit, ai ka pasur një qasje të butë ndaj fenomeneve negative dhe nuk ka arritur të garantojë zbatimin e ligjit në mënyrë të plotë dhe efektive, në përputhje me pritshmëritë e ligjvënësit, gazetarëve dhe shoqërisë civile. Rezoluta e Kuvendit, datë 21.06.2021, nuk ngre shqetësime të mëdha dhe jep vetëm tre rekomandime për përmirësimin e gjendjes, por ky nuk është kriteri i duhur matës i pritshmërisë së ligjvënësit, krahasuar me atë që ka qenë në momentin e miratimit të ligjit në vitin 2014.

Gjendja aktuale, e cila tashmë rezulton e konsoliduar në nivele problematike, ëshë pasojë edhe e disa mangësive që ka vetë ligji për të drejtën e informimit, por qasja e butë e Komisionerit ndaj rasteve të refuzimit të ndërgjegjshëm të dhënies së informacionit, apo toleranca ndaj vonesave në përgjigje dhe ndaj përgjigjeve të paplota, ka sjellë zbutjen e forcës reale që ka ligji, megjithë mangësitë e tij.

Një pjesë e të dhënave për qëllim të monitorimit janë marrë nga faqja e internetit e Komisionerit, ndërsa pjesa tjetër është marrë nga përgjigjet e kërkesave për informacion drejtuar zyrës së tij.


Është për të theksuar që në fokus kemi pasur punën e kësaj zyre në trajtimin e ankesave dhe monitorimin e programeve të transparencës si detyrime ligjore, duke lënë jashtë vëmendjes veprimtaritë promovuese, trajnimet dhe projektet e ndërmarra nga zyra e Komisionerit, si të një rëndësie dytësore. Gjithashtu, nuk është pjesë e këtij raporti veprimtaria e Komisionerit që ka lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe konsultimin publik, si detyra të veçanta që i takojnë mbrojtjes së të drejtave që nuk janë në fokusin e të drejtës së informimit.

3.1. Numri i ankesave drejtuar Komisionerit



Numri i ankesave drejtuar Komisionerit për vitin 2021 është rritur ndjeshëm nga vitet e kaluara (me rreth 40%) dhe rezultojnë të jetë shifra më e lartë deri tani. Rritja e ankesave duhet parë nën një këndvështrim të dyfishtë: Nga njëra anë mund të vijë si pasojë e ndërgjegjësimit të qytetarëve, të cilët e përdorin më shumë këtë mekanizëm; nga ana tjetër mund të vijë edhe si pasojë e moszgjidhjes së problemeve në faza më të hershme, si për shembull duke mos plotësuar programet e transparencës, ose duke refuzuar pa asnjë shkak dhënien e informacionit.

3.2. Subjektet që i janë drejtuar Komisionerit



Raporti i numrit të ankimeve të gazetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile me qytetarët e thjeshtë na tregon nivelin e këmbënguljes së këtyre kategorive në marrjen e informacionit dhe na ndihmon të masim sa është niveli i informacionit sensitiv të refuzuar në krahasim me atë të zakonshëm, duke u nisur nga supozimi se kategoria e parë kërkon informacione me ndjeshmëri më të lartë, për shkak të aktivitetit të tyre investigativ dhe në antagonizëm me interesat e zyrtarëve nën presionin e llogaridhënies.

Nga të dhënat e pasqyruara në grafikun më lart, rezulton se numri i gazetarëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile për vitin 2021 ka vijuar të rritet. Numri i gazetarëve është rritur më shumë, ndërsa numri i organizatave është ulur në krahasim me vitin e kaluar. Pavarësisht kësaj, gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile paraqesin rreth dy të tretat e ankimesve, ndërsa pjesa tjetër janë qytetarë të zakonshëm. Kjo gjendje mendohet se diktohet për tre arsye: së pari, gazetarët dhe aktivistët janë kategoria më e interesuar për t'u informuar mbi veprimtarinë e organeve publike; së dyti, kjo kategori është ajo që refuzohet më shpesh nga institucionet, për shkak të informacionit sensitive që kërkojnë, si dhe, së treti, kjo kategori është edhe më këmbëngulëse në kërkesat për marrjen e informacionit, duke i shfrytëzuar të gjitha mundësitë ligjore, siç është ankimi administrativ.

Nisur nga interesimi i lartë i gazetarëve dhe organizatave jo fitimprurëse, mendojmë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit duhet t'i japë përparësi kësaj kategorie në trajtimin e ankesave të tyre. Kjo jo vetëm për shkak të numrit të madh të ankesave të bëra nga ta, por edhe për rëndësinë që ka informacioni në punën dhe aktivitetin e kësaj kategorie. Kujtojmë se përmes garantimit të së drejtës së tyre për t'u informuar garantohet edhe liria e shprehjes dhe informimi të publikut, kjo pasi gazetarët dhe aktivistët e shoqërisë civile informacionin që marrin nuk e kanë për përdorim vetjak, por për ta përpunuar dhe shpërndarë te publiku për interes të këtij të fundit.

3.3. Numri i vendimeve të marra nga Komisioneri

Në vijim tregohet se si është vendimarrja e Komisionerit në përfundim të shqyrtimit të ankesave:




Rezulton që për vitin 2021, numri i vendimeve të marra nga Komisioneri ka pësuar rritje. Por duke pasur parasysh që edhe numri i ankesave është rritur, raporti në përqindje me ankesat është 4 %, duke ruajtur një nivel tejet të ulët dhe madje më të ulët se në vitin e kaluar. Edhe këtë vit vihet re se një pjesë e mirë e ankesave vazhdojnë të trajtohen përmes praktikës së “zgjidhjes me mirëkuptim”, e promovuar nga Komisioneri si mjet efektiv, pavarësisht se kjo nuk është zgjidhje sipas ligjit. Në vlerësimin tonë, kjo praktikë nuk i shërben rritjes së efektivitetit të zbatimit të ligjit, por përkundrazi, ajo sjell vonesë të tepërt në dhënien e informacionit, shmangie nga sanksionet dhe keqedukim të shkelësve përsëritës, si dhe moskonsolidim të praktikës për shkak të numrit të ulët të vendimeve. Për të korrigjuar këtë praktikë sugjerojmë që të bëhen ndryshime ligjore, ku të sanksionohet detyrimi i Komisionerit për të trajtuar çdo ankesë me vendim.

Është vënë re gjithashtu se një pjesë e mirë e gazetarëve investigativë e vuajnë mungesën e vendimarrjes së Komisionerit për të Drejtën e Informimit, gjë që i ka çuar ata në disa raste ta kërkojnë realizimin e të drejtës së tyre përmes rrugës gjyqësore. Kjo u kushton atyre energji, shpenzime financiare dhe kohë në mënyrë të paarsyeshme.

3.4. Llojet e vendimeve

Komisioneri në vendimin e tij mund të vendosë mospranimin, pranimin ose rrëzimin e kërkesës dhe në rast të pranimit të kërkesës, kur ai e gjykon të arsyeshme mund të vendosë edhe sanksionet përkatëse. Në vijim jepen shifra lidhur me llojin e vendimarrjes së Komisionerit.




Siç rezulton nga grafiku më sipër, ku tregohet se nga Komisioneri janë pranuar 37 ankime, vetëm 3 vendime janë negative, në pamje të parë krijohet ideja se vazhdojnë të dominojnë vendimet pozitive të pranimit të ankesës, por duke marrë në konsideratë faktin se ky numër vendimesh është shumë i ulët krahasuar me numrin total të ankesave, rezultati nuk ka të njëjtën vlerë.

Njësoj edhe për këtë vit, raportohet se pjesa dërrmuese e ankesave trajtohen me mënyrën e zgjidhjes me mirëkuptim. Kjo mënyrë raportohet të jetë jo efektive nga gazetarë dhe aktivistë të kontaktuar nga Res Publica. Kujtojmë këtu që në vitin e kaluar kjo problematikë u evidentua dhe u hulumtua konkretisht dhe rezultoi se ky lloj trajtimi nuk ishte zgjidhje e ankesave, por në një pjesë të mirë të rasteve ishte thjesht një komunikim i Zyrës së Komisionerit me organin e administratës publike. I qendrojmë mendimit se mënyra e zgjidhjes me ndërmjetësim, përveçse rrit në mënyrë artificiale rastet e suksesit, sjell papërgjegjshmëri nga ana e institucioneve dhe ç'është më e rëndësishmja, ankesat nuk gjejnë zgjidhje, gjë që e vë Komisionerin në kushte kundraligjshmërie.

Kjo praktikë e promovuar edhe më herët nga Komisioneri si mjet efektiv, jo vetëm nuk rezulton efektive, por përkundrazi fsheh apatinë dhe mosreagimin e Komisionerit ndaj ankimeve të gazetarëve duke krijuar iluzionin e efektivitetit për të maskuar realitetin e dështimit të bërjes së transparencës, sidomos në rastet kur ajo ka rëndësi për investigimin e aferave të dyshuara korruptive. Ky fakt është konfirmuar tashmë edhe në proceset gjyqësore në disa raste.

3.5. Kohëzgjatja e marrjes së vendimeve nga Komisioneri


Sipas ligjit, Komisioneri duhet të marrë vendime brenda 15 ditësh pune. Ligji parashikon që në rast se Komisioneri nuk shprehet brenda këtij afati, atëherë ankuesit i lind e drejta që t'i drejtohet gjykatës. Në grafikun në vijim jepen të dhëna mbi këtë parametër të matur.



Siç vihet re nga grafiku i mësipërm, ky parametër është përkeqësuar. Gjatë vitit 2021, Komisioneri ka marrë vendimin brenda afatit ligjor vetëm në 23% të rasteve krahasuar me vitin 2020, ku rezulton se Komisioneri ka respektuar afatin ligjor në 69% të rasteve.

Mosmarrja e vendimeve brenda afatit nga ana e Komisionerit, përkeqëson edhe më shumë realizimin e qëllimit të ligjit që është sigurimi i informacionit brenda një kohe të shkurtër.

3.6. Aplikimi i sanksioneve



Sanksionet me gjobë gjatë vitit 2021 kanë qenë më të lartat që nga miratimi i ligjit në vitin 2014. Janë vënë gjithsej 8 gjoba, por ka një veçori, që 6 gjoba janë vendosur për mosrespektim të detyrimeve për programet e transparencës. Ndërsa për ankesat e qytetarëve janë vendosur 2 gjoba. Gjithsesi, numri i sanksioneve mbetet shumë i ulët në raport me shkeljet që mund të konstatojë Komisioneri.

Është konstatuar edhe këtë vit diferencë e madhe midis nivelit të sanksioneve për shkeljet e të drejtës së informimit në raport me shkeljet në fushën e të dhënave personale. Konkretisht për mbrojtjen e të dhënave personale, çdo vendim pranimit ankese është shoqëruar me gjobë, ndërkohë që gjobat e vëna në rast të pranimit të vendimeve për shkelje të së drejtës së informimit rezultojnë vetëm në 5% të rasteve.

Siç u paraqit më sipër, gjatë vitit 2021 Komisioneri ka trajtuar 992 ankesa. Vendosja e vetëm 2 gjobave gjatë një viti për të gjitha këto ankime, është një shifër e pakonsiderueshme dhe nuk ndihmon rritjen e përgjegjshmërisë. Qasja e Komisionerit vazhdon të jetë e njëjta, duke synuar edukimin përmes vendimeve të pranimit të ankesës, edhe pse në fare pak raste, përmes trajnimeve, seancave dëgjimore, aktiviteteve publike promovuese për të drejtën e informimit, por me sa më pak ushtrim force ndaj shkelësve. Pas 7 vitesh nuk mund të pretendohet që edukimi vjen vetëm përmes frymëzimit e ndërgjegjësimi, ndaj duhet përdorur edhe vendosja e sanksioneve që ligji i ka dhënë ekskluzivisht këtij institucioni. Pas 7 vitesh nuk mund të pretendohet se shkelësit nuk e njohin ligjin, apo që nuk do ishte në përputhje me gjendjen.

Gjithashtu, justifikimi i dhënë shpesh herë nga Komisioneri se përdorimi i vendimeve dhe sanksioneve bëhet vetëm në raste ekstreme, nuk vlen si shpjegim. Në këtë mënyrë, mbetet të supozojmë se për të drejtën e informimit Komisioneri në mënyrë të ndërgjegjshme bën diferencime të mëdha duke marrë më pak vendime dhe vendosur shumë më pak sanksione,

pavarësisht numrit më të lartë të ankesave dhe interesit tepër të madh për përdorimin e kësaj të drejte në një shoqëri demokratike.

Përpos sa më sipër, vlen të përmendet rasti i trajtimit në një prej dy vendimeve të dhëna me gjobë për refuzim të dhënies së informacionit, ka sanksionuar drejtpërdrejtë Sekretarin e Përgjithshëm të Autoritetit Publik (Bashkia Bulqizë), pasi ky i fundit ka trajtuar de facto kërkesën për informacion dhe ka penguar koordinatorin e institucionit për zbardhjen e saj.

Përsa i përket mosplotësimit të programeve të transparencës, interesant është fakti se Komisioneri ka shoqëruar me vënie gjobash të gjitha rastet e trajtuara me vendim. Gjithsej 6 vendimet të marra nga ai kryesisht mbi transparencën proaktive janë shoqëruar me gjobë. Ky fakt sugjeron për një qendrim më strikt të Komisionerit ndaj informimit proaktiv të institucioneve publike, që duket se mund të jetë edhe një shkak i vlefshëm për përmirësimin e shfaqur gjatë këtij viti në lidhje me programet e transparencës, me afro 13%, siç trajtohet në faqet 21-22 të këtij raporti.

Nëse ky mjet do të sjellë efekte më tej, kjo do të mund të shihet në nivelin e transparencës proaktive në vitin 2022.

4. TRANSPARENCA E INSTITUCIONEVE

4.1. Reagimi i institucioneve ndaj kërkesave për informacion

Res Publica ka vijuar edhe për vitin 2021 të testojë sjelljen e institucioneve ndaj kërkesave për informacion. Gjatë këtij viti Res Publica u ka dërguar institucioneve të ndryshme 167 kërkesa për informacion. Për të vlerësuar të dhënat janë marrë në konsideratë ato kërkesa që kanë përfunduar (157) në të gjitha etapat dhe gjetjet janë krahasuar me vitet e mëparshme.

Për efekt të këtij studimi janë monitoruar të njëjtët komponentë me studimet e mëparshme, si vijon:

- Fusha e informacionit të kërkuar;
- Kategoria e institucioneve të pyetur;
- Sasia dhe cilësia e përgjigjeve ndaj kërkesës fillestare;
- Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes pas kërkesës fillestare;
- Reagimi i institucioneve pas ankimit administrativ të Komisioneri;
- Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes pas depozitimit të ankimit administrativ.


4.1.1. Fusha e informacionit të kërkuar

Fushat në të cilat është kërkuar informacion janë të larmishme dhe renditen si më poshtë nga fusha me më interes në atë me më pak interes:

- Mjedisi dhe burimet natyrore;
- Punët publike;
- Arsimi;
- Rindërtimi;
- E drejta e punës;
- Drejtësia;
- Shëndetësia;
- Prokurime publike;

4.1.2. Reagimi i institucioneve ndaj kërkesave fillestare

Situata e sjelljes së institucioneve ndaj kërkesave fillestare për vitin 2021 paraqitet si më poshtë:



Konstatohet se situata e kthimit të përgjigjeve është e njëjtë me atë të vitit 2019 dhe pak fare më e mirë se ajo e vitit 2020 kur vendi u prek nga efektet e masave anti Covid19.


Kërkesat fillestare për informacion kanë marrë përgjigje të plota në 60 % të rasteve dhe, duke përfshirë edhe përgjigjet e pjesshme, ato arrijnë në nivelin 77%. Megjithatë ajo që vlen të theksohet është se numri i përgjigjeve nuk tregon domosdoshmërisht transparencë dhe përgjegjshmëri më të lartë nëse kjo nuk shoqërohet me reagim të shpejtë brenda një afati të arsyeshëm dhe dhënie të informacioneve sensitive, të cilat kryesisht kërkohen nga gazetarët dhe aktivistë/organizata të shoqërisë civile. Këto raste vijojnë të jenë kategoria më e refuzuar nga zyrat e shtetit. Nga intervistat e kryera nga stafi i qendrës Res Publica me disa gazetarë investigativë rezulton se informacionet lidhur me krizën, si dhe shumë informacione të tjerë të rëndësishëm për hulumtimet e tyre, nuk kanë gjetur përgjigje.

Duhet theksuar se edhe gjatë vitit 2021, një pjesë e mirë e efekteve të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 ishin të njëjta ose të ngjashme me ato të vitit 2020.

Për hartuesit e këtij raporti mbetet sfida e vështirë sjellja e treguesve cilësorë për të vlerësuar transparencën e institucioneve. Nga njëra anë, paraqet vështirësi vlerësimi objektiv se cili informacion është më sensitiv dhe cili jo. Kjo gjë varet nga perceptimi i gazetarit dhe i publikut në një kontekst të dhënë. Nga ana tjetër, qendra Res Publica njihet tashmë nga një mori autoritetesh publike dhe ka gjasa që t'i trajtojnë këto kërkesa me më shumë dilijencë, duke e ditur që Res Publica i ndjek çështjet te Komisioneri dhe në gjykatë. Grupi i punës së këtij raporti mendon që gazetarët dhe aktivistët që nuk njihen për insistues, trajtohen në një mënyrë ndryshe, me më pak seriozitet.

4.1.3. Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare

Situata e sjelljes së institucioneve ndaj kërkesave fillestare për vitin 2021 paraqitet si më poshtë:



Kohëzgjatja mesatare e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesës fillestare gjatë vitit 2021 është 27 ditë kalendarike. Ky tregues paraqitet më keq se vitet e tjera, duke shënuar një rekord negativ. Madje, gjatë vitit 2021 kohëzgjatja mesatare e përgjigjes ndaj kërkesave fillestare është më e gjatë se ajo e vitit 2020, i ndikuar më fort nga gjendja e fatkeqësisë natyrore, si dhe 3 ditë më e gjatë se ajo e vitit 2013, kur në fuqi ishte ligji nr. 8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentat zyrtare” (ligji i vjetër).


Theksojmë se afati ligjor prej 10 ditësh pune (zakonisht 14 ditë kalendarike) është afat maksimal. Edhe sikur ky afat të respektohej nga institucionet, situata nuk duhet të ishte e kënaqshme, pasi pritshmëritë janë që institucionet të përgjigjen edhe në kohë më të shpejtë se afati ligjor maksimal, i cili mund të jetë i pranueshëm si përjashtim, në rastet komplekse, ku dhënia e informacionit nuk mund të jepet brenda një ose pak ditëve.

Pra, situata vazhdon të jetë larg optimale edhe në këtë aspekt, kur nuk kapet as maksimumi i afatit ligjor. Informacioni ka vlerë kur jepet shpejt.

I vetmi mjet efektiv që do të siguronte respektimin e afatit ligjor nga institucionet është në duart e Komisionerit, nga i cili pritët të merren masat respektive në këtë kontekst. Si alternativë sugjerojmë edhe ndryshime ligjore që do të përcaktonin mënyra të qarta për dëmshpërblimin, duke vendosur kritere të matshme të kuantifikimit të dëmit, që personi përgjegjës i detyrohet kërkuarit, i cili është edhe i dëmtuari në këtë kuptim.

4.1.4. Reagimi i institucioneve pas dorëzimit të ankimit administrativ

Reagimi i institucioneve pas dorëzimit të ankimit administrativ për vitin 2021 paraqitet më poshtë:



Siç rezulton nga grafiku i mësipërm, kemi nivel të njëjtë me vitin e kaluar të nivelit të reagimit të institucioneve pas dorëzimit të ankimit administrativ, krahasuar me vitin e kaluar. Mbetet i vërtetë fakti që niveli i reagimit të institucioneve pas ankimit administrativ është i lartë, duke shtuar nevojën për të inkurajuar kërkesit të paraqesin ankesa te Komisioneri.

4.1.5. Kohëzgjatja e reagimit të institucioneve pas ankimit administrativ



Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjeve nga institucionet pas ankimit administrativ, para se Komisioneri të marrë një vendim, është matur për të parë ndjeshmërinë e institucioneve edhe në këtë hallkë.

Grafiku i mësipërm evidenton se kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes së institucioneve pas ankimit të Komisioneri për vitin 2021 është përkeqësuar duke shtuar me 4 ditë kohën e kthimit të përgjigjeve, krahasuar me vitin e kaluar dhe përbën situatën më të keqe të tre viteve të fundit.


4.2. Vlerësimi i transparencës proaktive

4.2.1. Programet e transparencës

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” parashikon detyrimin e autoriteteve shtetërore që të publikojnë disa lloje informacionesh pa pasur nevojë për të paraqitur kërkesë. Këto informacione duhet të publikohen në mënyrë proaktive nga vetë autoriteti publik. Ideja fillestare e ligjvënësit ishte të lehtësonte aksesin në informacion për afro 80% të informacioneve që kërkohen zakonisht, duke i bërë ato të jenë të aksesueshëm në internet me lehtësinë e një kliku.

Pas 7 vitesh supozohet që terreni të jetë i gatshëm me infrastrukturën e duhur dhe njohuritë e duhura për të aksesuar informacion rregullisht nga programet e transparencës. Në raportet e viteve të kaluar u vu re se përmirësimi i programeve të transparencës ka ndaluar prej kohësh në nivele mediokre.

Për të vlerësuar nivelin e transparencës përmes publikimit të informacioneve dhe dokumenteve nga institucionet me nismën e tyre, Res Publica monitoroi të gjitha rubrikat e programeve të transparencës dhe përditësimin e tyre për 100 institucionet kryesore gjatë vitit 2021.




Siç shfaqet në grafik, në vitin 2021 ka një përmirësim të lehtë, por jo domethënës në përmbushjen e programeve të transparencës, duke u reduktuar lehtë numri i institucioneve që nuk kanë program transparence dhe duke u shtuar pak numri i institucioneve që e kanë përmbushur kënaqshëm këtë program.

Megjithë përmirësimin e lehtë, situata mbetet ende problematike. Ndër 100 autoritetet publike më të rëndësishëm në vend, 14 prej tyre nuk kanë fare një program transparence. Pjesa kryesore (60 %) kanë përmbushur pjesërisht programet e transparencës (me më pak se gjysmën e informacionit) dhe vetëm 26 % e institucioneve kanë përmbushur kënaqshëm programet e transparencës (me mbi 50% të informacionit). Asnjë institucion nuk ka përmbushur plotësisht programin. Ndonëse ka progres, ai paraqitet i ngadaltë dhe në nivele mediokre.

Gjithashtu vihet re se në masën dërrmuese në programet e transparencës, qoftë edhe në ato raste kur rubrika është përmbushur jo keq, mungojnë informacione që vërtet kanë vlerë për t'u publikuar ku spikat mangësia pothuajse totale e informacionit për monitorimin e kontratave të prokurimit publik dhe/ose koncesioneve (në 99% të rasteve).

Miratimi i modeleve specifike të programeve të transparencës, të përshtatur sipas natyrës dhe kompetencave të çdo institucioni mbetet një domosdoshmëri.


Sipas llojit të institucioneve, gjendja gjatë vitit 2021 paraqitet si më poshtë:



Siç vihet re, të gjitha kategoritë janë larg standardeve të duhura. Institucionet kushtetuese dhe ato të pavarura paraqiten në një nivel më të mirë se kategoritë e tjera, ndërsa më keq paraqiten organet e pushtetit vendor dhe ato të varësisë së pushtetit qendror, të cilët kanë edhe barrën më të madhe të menaxhimit të përditshëm të fondeve publike dhe punëve me interes të drejtpërdrejtë të qytetarëve.

4.2.2. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

Mbajtja e një regjistri të posaçëm ku pasqyrohen kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigjet e tyre është një detyrim që parashikohet nga neni 8 i ligjit për të drejtën e informimit. Ky regjistër shërben për të lehtësuar marrjen e informacionit nga çdo kërkuar, në rast se dikush tjetër ka kërkuar më parë po të njëjtin informacion, pa pasur nevojë për të bërë një kërkesë të re.



Nga të dhënat e mbledhura rezulton se edhe këtë vit situata është më e mirë se ajo e vitit të kaluar, ndonëse ende larg standardeve. Për herë të parë pas 7 vitesh vihet re se 3/4 e institucioneve kanë plotësuar të paktën pjesërisht kërkesat për mbajtjen e regjistrit. Megjithatë vetëm 13% e tyre i kanë përgjigjet e aksesueshme.

4.2.3. Caktimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit

Caktimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit është përmirësuar nga 73% në 86%, pas një stanjacioni të gjatë. Megjithatë, mbetet shqetësuese që edhe në vitin 2021 vihet re se ende 1/10 e institucioneve nuk kanë caktuar një koordinator për të drejtën e informimit, ose të paktën nuk e kanë bërë këtë gjë publike.

5. ÇËSHTJE ME INTERES TË VEÇANTË PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT GJATË VITIT 2021

Qendra Res Publica, përveç monitorimit të zakonshëm të veprimtarisë së autoriteteve publike në kuadër të respektimit të së drejtës për informim, sjell në vemendje çështje që lidhen me aspekte të veçanta të së drejtës së informimit, problematika të evidentuara edhe më parë, të cilat ende sot mbeten të pazgjidhura duke shtruar kështu debate juridike që përfshijnë edhe përplasjen mes të drejtës së informimit dhe të drejtave të tjera apo edhe fenomene të reja të ndodhura gjatë këtij viti.

5.1. Agjencia e Medias dhe Informimit, një krijesë sui generis që ndërhyr në të drejtën e informimit

Në shtator të vitit 2021 Këshilli i Ministrave vendosi të krijojë Agjencinë e Medias dhe Informimit, e panjohur më parë për realitetin mediatik shqiptar. Sipas VKM nr. 512, datë 18.09.2021 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Media dhe Informim”, e cila përbën dhe aktin e themelimit të Agjencisë, përcaktohet se misioni i saj do të jetë:

“...sigurimi i transparencës në lidhje me politikat, aktivitetet, projektet, eventet, si dhe qëllimin, objektivat, risitë apo problematikat që zgjidhen nëpërmjet akteve të Këshillit të Ministrave dhe të akteve të tjera të ministrave dhe çdo institucioni të administratës shtetërore”.

Pyetja e parë që lind në këto kushte është: Pse kjo krijesë e re, çfarë qëllimi dhe misioni të parregulluar deri më tani kërkon të plotësojë në aspektin e të drejtës për informim?

Fillimisht, kjo pyetje e gjen përgjigjen nga leximi në tërësi i këtij akti, por dhe relacionit shpjegues bashkangjitur aktit, ku vihet re se kjo strukturë nuk do të kryejë asnjë funksion/detyrë që nuk kryhet aktualisht, në drejtim të së drejtës për akses në informacion. Më specifikisht, në detyrat e caktuara për këtë agjenci përshihen ndër të tjera dhe:

- **Drejtimi dhe koordinimi i punës së strukturave/ nëpunësve përgjegjës për informimin** dhe komunikimin mediatik si dhe koordinimi i organizimit të aktiviteteve informuese, konferencave për shtyp dhe çdo event publik të këtyre institucioneve.
- **Vlerësimi, përmbledhja dhe përditësimi i informacionit që do të publikohet**, në lidhje me punët e Këshillit të Ministrave dhe administratës shtetërore në varësi të tij, si dhe çështjet me interes publik;
- **Sigurimi i përgjigjeve për shkresat dhe kërkesat për informacion**, në lidhje me çështjet e informimit dhe komunikimit mediatik apo çështje të tjera në fushën e saj të përgjegjësisë si dhe koordinimi, drejtimi i fushatave të informimit publik në lidhje me çështjet e fushës së përgjegjësisë të ministrive dhe institucioneve të tjera të administratës shtetërore.

Nga sa më sipër, vërejmë se krijimi i Agjencisë për Median dhe Informimin në të vërtetë mund të "eklipsojë" strukturat ekzistuese që ushtrojnë funksionet e mësipërme dhe më konkretisht evidentohen këto shqetësime:

- a. Centralizimi i një aktiviteti në parim nuk i shërben demokratizimit dhe rasti në fjalë nuk bën përjashtim. Kështu, në çdo institucion të nivelit të lartë qendror dhe vendor, funksionet e parashikuara në VKM-në në fjalë kryhen tipikisht nga zëdhënësi i shtypit, zyrat e marrëdhënieve me jashtë, kabineti i titullarit, koordinatorët për të drejtën e informimit etj. I vetmi funksion i parregullar më parë është centralizimi i aktivitetit të këtyre strukturave, që tashmë do të jenë në varësi të Agjencisë, ku kjo e fundit është në varësi direkte të Kryeministrit.
- b. Krijimi i kësaj agjencie në mënyrën si është konceptuar me gjasa nuk do të ndihmojë në informimin më të mirë dhe më të shpejtë të publikut, por do të sigurojë kontroll më të strukturuar mbi informacionin që hyn dhe del në zyrat e ekzekutivit dhe nga zyra pranë Kryeministrit. Të gjitha dispozitat e këtij akti sugjerojnë këtë konkluzion.
- c. Krijimi i kësaj agjencie rrezikon të sjellë konfuzion te gazetarët dhe përplasje kompetencash mes institucioneve. Nëse do të kemi përqendrim të informacionit tek një agjenci atëherë gazetarët me të drejtë do të kërkojnë informacion aty dhe nëse ai refuzohet, do të ankohen te Drejtori i Agjencisë, duke mos përdorur kanalet ligjore të ligjit për të drejtën e informimit që janë koordinatori për të drejtën e informimit dhe Komisioneri. Kjo mund të sjellë konfuzion.
- d. Kjo strukturë shihet problematike në raport me lirinë e shprehjes, pasi lajmet e parapërgatitura nga kjo Agjenci do të jenë edhe ushqimi kryesor i mediave. Nëse deri tani ky fenomen raportohej se ekzistonte në mënyrë të theksuar për disa zyra qendrore (Kryeministri/Bashkia), me krijimin e kësaj agjencie, ky fenomen stabilizohet në cdo institucion.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit nuk u mor parasysh në hartimin e vendimit për krijimin e Agjencisë. Res Publika iu drejtua me një kërkesë për informacion për të kuptuar rolin e këtij institucioni në hartimin e këtij vendimi. Zyra e Komisionerit u përgjigj:

"Nuk kemi asnjë korespondencë në lidhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mediat dhe Informimin"

Anashkalimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit përbën problem, për sa kohë krijimi i kësaj agjencie prek çështje të informimit. Më konkretisht prek edhe pjesën proaktive të informimit që zakonisht e njohim nga ligji me termin “programet e transparences”, por prek sigurisht edhe të gjithë informacionet që do të jepen në bazë kërkesë, sidomos në rastin e gazetarëve.

5.2. Diskutime mbi draftin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”

Në fund të vitit 2021 Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka publikuar një draft të hartuar “Për disa ndryshime mbi ligjin nr.119/2014”. Kjo nisëm ligjore vjen për shkak të nevojës së diktuar për të bërë ndërhyrje në këtë ligj dhe për të adresuar problematika të evidentuara nga praktika ndër vite, që prej momentit kur ligji ka hyrë në fuqi.

Një nga risitë e këtij projektligji është edhe dispozita që i bën Vendimet e Komisionerit “titull ekzekutiv”. Ky është një mekanizëm i favorshëm për të drejtën e informimit, për të cilin Res Publica prej vitesh e ka rekomanduar.

Ka edhe aspekte të tjera të kritikueshme si për shembull, në projektligjin e propozuar parashikohet përjashtimi i veprimtarisë së gjykatave dhe prokuroria nga fusha e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, gjë që përbën regres të të drejtave të njohura nga legjislacioni i sotëm.

Ky projekt ligj është në fazën e konsultimit publik. Aspekte të këtij projektligji janë kritikuar në këtë fazë nga gazetarë dhe organizata të shoqërisë civile. Për këtë arsye një grup organizatash të shoqërisë civile kanë marrë pjesë në tryeza debatesh ku i ftuar ka qenë edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit në rolin e nismëtarit të ndryshimeve ligjore që propozohen, gazetarë etj dhe po përgatiten të marrin pjesë në konsultim përmes rekomandimeve për përmirësime të këtij drafti.

5.3. Konventa e Tromsos

Në datën 28.01.2022 Republika e Shqipërisë ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës “Mbi Aksesin në Dokumente Zyrtare”, datë 18.06.2009. Kjo Konventë në nenin 1/2 të saj parashikon se:

Për qëllime të kësaj Konvente:

i. “autoritete publike” do të thotë:

1. qeverisje dhe administratë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal;
2. organet legjislative dhe autoritete gjyqësore, për aq ato ushtrojnë funksione administrative, në përputhje me legjislacionin e brendshëm;
3. personat fizikë apo juridikë, për aq sa ata ushtrojnë autoritet administrativ.

ii. Secila Palë ka mundësi, në momentin e nënshkrimit ose kur deponon instrumentin e tij të ratifikimit, njohjes, miratimit apo aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të deklarojë se përkufizimi i “autoriteteve publike” përfshin gjithashtu një apo më shumë nga të mëposhtmet:

1. organe legjislative sa i takon aktivitetet e tyre të tjera;

2. *autoritete gjyqësore sa i takon aktiviteteve të tyre të tjera;*
3. *persona fizikë apo juridikë, për aq sa ata ushtrojnë funksione publike apo ushtrojnë aktivitetin me fonde publike, në përputhje me të drejtën kombëtare.*

Shqipëria nuk ka bërë ende asnjë deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, që të deklarojë se përkufizimi i “autoriteteve publike” përfshin gjithashtu:

- organet legjislativë, sa i takon aktiviteteve të tyre të tjera;
- autoritetet gjyqësore, sa i takon aktiviteteve të tyre të tjera;
- personat fizikë apo juridikë, për aq sa ata ushtrojnë funksione publike apo ushtrojnë aktivitetin me fonde publike, në përputhje me të drejtën kombëtare.

Ligji nr. 119/2014, si një ligj që u rendit i 6-ti në botë për nga niveli i garancive në aksesin në informacion, si një ligj inovativ që e shtrin fushën e veprimtarisë edhe në veprimtarinë e autoriteteve legjislativë dhe gjyqësore, sa i takon aktiviteteve të tjera të tyre, përveç veprimtarisë administrative. Gjithashtu ligji ynë përfshin edhe detyrimin e personave fizikë e juridikë, për aq sa ata ushtrojnë funksione publike.

Mos dërgimi i deklaratës drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për të përfshirë edhe këto veprimtari, duke u shoqëruar me propozimin e një draft-amendamenti të ligjit aktual që gjithashtu kufizon këto veprimtari, duke zvogëluar fushën e veprimtarisë së zbatimit të ligjit, përbën një përpjekje të qëllimtë dhe regresive sepse përjashton veprimtari me interes për publikun (gjyqësore, hetimore, ligjvënëse) duke lënë vetëm veprimtarinë administrative, që ka të bëjë me shpenzimin e buxhetit, tendera, etj.

Tendenca e vendeve anëtare të Konventës dhe vendeve të rajonit është që të shkojnë drejt modeleve që e zgjerojnë fushën e veprimtarive dhe jo drejt modelit të kundërt që synohet aktualisht me projektligjin në fjalë.

5.4. Tarifa e dhënies së informacionit, “dogana” që duhet kaluar për marrjen e informacionit

E drejta për t’u informuar është një ndër të drejtat kryesore dhe kuadri ligjor që rregullon aspekte të ndryshme të kësaj të drejte është ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Midis shumë çështjeve që trajton ky ligj është edhe kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar. Sipas nenit 13 të këtij ligji parashikohet se dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Në çdo rast, kjo kosto duhet të përkojë me koston reale të riprodhimit të informacionit.

Me Urdhërin nr. 86, datë 17.04.2015 “Për tarifat për dhënien e informacionit (dokumentacionit) të kërkuar” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit parashikohet se:

- “Tarifa e shërbimit të informacionit (fotokopje ose CD) do të jetë si më poshtë:*
- *Deri në 10 fletë informacioni jepet pa pagesë;*
 - *Mbi 10 fletë, për formatin A4, pagesa do të jetë 5 lekë/fleta.*
 - *Për informacionin e dhënë me CD, pagesa do të jetë 60 lekë/CD.”*

Së pari, vlen të theksohet se tarifat e përcaktuara nga ana e Komisionerit sërish janë më të larta se kostoja reale në treg e shërbimit të fotokopjes, e cila ofrohet dhe me 2 lekë/fletë, ku përfshihet jo vetëm kostoja e materialit (letër dhe bojë), por edhe shërbimi, kostot indirekte, si dhe fitimi i subjektit së bashku me barrën fiskale. Dukshëm, kostoja është nën 2 lekë për fletë dhe kjo mund të reflektohet edhe në tarifat që duhen aplikuar për të dretën e informimit.

Së dyti, pavarësisht parashikimeve të këtij Urdhëri, autoritetet publike vijnë ende të aplikojnë tarifa të ndryshme, duke injoruar haptazi Urdhërin e sipërpërmendur. Kjo ka lënë vend për paqartësi në rastin më të mirë, për të mos thënë abuzim nga ana e institucioneve.

Së treti, ndonëse ligji parashikon që informacionet e marra në rrugë elektronike jepen falas, ky rregull nuk aplikohet gjithmonë dhe autoritetet publike shpesh justifikohen me faktin që informacionin nuk janë në version elektronik, duke refuzuar të skanojnë dokumentet dhe detyruar më pas kërkuesin të paguajë shërbimin fotokopje me tarifat e larta.

Nga ana tjetër, ndonëse ligji “Për të drejtën e informimit” i jep mundësinë Komisionerit së bashku me Ministrinë e Financave të zhvillojë kryesisht monitorime periodike për tarifat e vendosura nga autoritetet publike me qëllim evitimin e abuzimeve, gjendja vijon të mbetet e njëjtë në disa autoritete.

Përgjatë vitit 2021, në dy raste Komisioneri është vënë në lëvizje për të trajtuar ankimet e sjella nga Res Publica lidhur me koston e lëvrimit të informacionit.

Në të dyja rastet, qendrës Res Publica iu kërkua nga Insitituti i Ndërtimit pagimi i shumës prej mbi 100.000 lekësh (rreth 1000 EUR) për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (394 faqe), pasi sipas autoritetit për formatin A4 cmimi i koston do të përlllogaritet 300 lekë/faqe. Kjo shifër është haptazi shumë herë më e lartë se ajo e përcaktuar nga Komisioneri dhe edhe më e lartë se çmimi real i kostove për prodhimin e dokumentacionit.

Për sa më sipër, Komisioneri ka kërkuar vlerësimin e tarifave të vendosura nga autoriteti publik, Ministrisë së Financave, por ende nuk ka një qendrim final, ndonëse ndodhemi shumë muaj pas kërimit të informacionit. Kjo reflekton neglizhencën e organeve publike dhe indiferencën për të adresuar këtë problematikë duke mbajtur peng për rrjedhojë individët që kërkojnë lëvrimin e informacionit.

Duke marrë në konsideratë faktin se qendrimet e ndryshme të autoriteve publike për tarifat kanë vështirësuar aksesin e qytetarëve në të drejtën për informim, unifikimi i procesit të përcaktimit të tarifave nga Komisioneri në bashkëpunim me Ministrinë e Financave do të evitonte maksimalisht abuzimet dhe paqartësitë nga ana e autoriteteve.

Komisioneri gjithashtu duhet të vendosë rregull në lidhje me prodhimin e informacionit të skanuar, i cili duhet të prodhohet nëse kërkohet nga kërkuesi. Shpesh, nuk është problemi te kostoja e riprodhimit të informacionit, më shumë se te fakti që kërkuesi duhet të shkojë te autoriteti publik, të tërheqë një kopje të faturës, të shkojë më pas në një bankë të caktuar për të bërë pagesën dhe më pas të shkojë përsëri te autoriteti publik të tërheqë informacionin, pasi tregon dokumentin e pagesës në zyrën e financës, edhe në ato raste kur kostoja është më pak se 200 lekë. Kështu, pagesa shndërrohet në rritje vështirësie dhe shpenzim kohe, kosto shtesë si komisionet bankare, duke bezdisur dhe dekurajuar kërkuesin.

5.5. Akses i gazetarëve në informacion rreth proceseve gjyqësore dhe roli i gjyqtarit të medias

5.5.1. Gjyqtari i medias

Për herë të parë me ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e sistemit gjyqësor”, u prezantua “gjyqtari për median”, i cili ka për kompetencë të ushtrojë ose të mbikqyrë shërbimet e marrëdhënieve me publikun, duke u kujdesur për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), me qëllim që:

- a) t’i sigurohet medias dhe publikut informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet për çështje të caktuara;
- b) t’i komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik;
- c) të mbahen kontakte me median për seancat gjyqësore të çështjeve që kanë interes të veçantë publik;
- ç) të sigurohet informacion, në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”, në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore;

Gjithashtu, në po të njëjtën dispozitë parashikohet publikimi i të gjitha vendimeve gjyqësore në përputhje me ligjin. E gjithë kjo konsiderohet si shërbim i marrëdhënieve me publikun që ndërvepron dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi ecurinë e marrëdhënieve me publikun pranë gjykatave dhe kërkon mendimin e tij kur është e nevojshme.

Në zbatim të kësaj dispozite, në vitin 2019 KLGJ caktoi 8 gjyqtarë për median për çdo juridiksion apeli dhe gjatë vitit 2020 prej saj u miratua plani strategjik për mënyrën e komunikimit me publikun dhe median të organeve të sistemit gjyqësor.

Aktualisht ka jo shumë praktikë në këtë funksion, kjo për shkak se gazetarët ende nuk e njohin këtë mekanizëm të ri, por praktika e deritanishme raportohet të jetë pozitive.

Si shembull mund të sjellim Gjykatën e Apelit Tiranë, ku sipas informacionit të venë në dispozicion nga gjyqtarja e medias së kësaj gjykate për qendrën Res Publica, në vitin 2021, në Gjykatën e Apelit Tiranë u emërua një nëpunës gjyqësor që do të mbulonte posaçërisht marrëdhënien e medias me gjykatën. Në këtë kuptim, nga pikëpamja formale, gjyqtari i medias nuk merr vendime për çdo çështje apo kërkesë që i drejtohet gjykatës. Në rastin kur çështja mbart diskutime mbi mënyrën e trajtimit (sikurse mund të jetë përplasja e të drejtës për informim, me të drejtat e tjera të garantuara), vjen në ndihmë vlerësimi i gjyqtarit të medias. Kjo realizohet nëpërmjet komunikimeve të përditshme mes tij dhe punonjësve gjyqësorë, që kërkojnë opinionin përkatës. Gjithashtu është evidentuar një fluks i lartë i kërkesave për informacion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për të cilat, sipas informacionit të disponuar nga gjyqtarja e medias së Gjykatës së Apelit Tiranë, janë angazhuar gjyqtarët e medias.

Për vitin 2021, nëpunësi i emëruar në këtë gjykatë ka krijuar bazën e të dhënave të kontaktit me gazetarët që raportojnë lajme nga gjykata. Nëpërmjet krijimit të grupit në platformën Whatsapp, i cili përditësohet me hyrje të reja të gazetarëve të interesuar, janë transmetuar informacionet për çështjet me interes publik, kryesisht çështje penale. Nëpërmjet kësaj synohet që gjykata të mos japë vetëm informacionin e kërkuar, përmes procedurave burokratike të parashikuara në ligj, por kur është vendi, informacioni të jepet në mënyrë pro aktive.

Nga ana tjetër, kjo gjykatë me miratimin e Këshillit të Gjykatës ka ndërmarrë nismën “Për një gjykatë të hapur”, duke ftuar çdo person të interesuar të vizitojë ambientet e gjykatës, të premtën e fundit të çdo muaji.

5.5.2. Nga ana tjetër vijojnë përpjekjet për anonimizimin e vendimeve gjyqësore

Anonimizimi i vendimeve gjyqësore është një përpjekje në vazhdim e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, e cila pritët të konkretizohet me një Udhëzim të ri të kësaj zyre, që ka ende formën e një drafti me titull “Për mënyrën e publikimit të vendimeve gjyqësore në portalin elektronik të gjykatave si dhe në faqet zyrtare të internetit të gjykatave.”

Titulli i aktit krijon idenë që objekti është rregullimi i publikimit të vendimeve gjyqësore, por në brendësi objekti i vërtetë është kufizimi i publikimit të këtyre vendimeve në faqet e internetit të gjykatave. Ky udhëzim nuk rregullon mënyrën e publikimit, por mënyrën e kufizimit të aksesit në dosje dhe vendimet gjyqësore në mënyrë fizike dhe elektronike dhe nevojitet që të reflektohet kjo frymë që në titullin e aktit.

Në parim ky udhëzim përfaqëson një ndërhyrje në një të drejtë kushtetuese, gjë që është e nevojshme të theksohet, se mund të kufizohet vetëm me ligj. Për këtë arsye, nevojitet të shihet baza ligjore përkatëse nëse ajo funksionon vërtet si një normë referuese për të lejuar një akt nënligjor të legjitimojë një ndërhyrje në këtë të drejtë.

Disa probleme themelore në lidhje me këtë draft janë:

a. *Drafti nuk ka marrë parasysh parimin e open justice, sipas të cilit veprimtaria gjyqësore është e hapur, përvec rasteve përjashtimore.*

Një parim që duhet të udhëheqë publikimin e vendimeve gjyqësore është parimi se aksesit në veprimtarinë gjyqësore (aksesit në dosje dhe në vendim) duhet të jetë pa limit (si rregull), përvec rasteve të caktuara (si përjashtim). Drafti në fjalë udhëhiqet nga parimi i kundërt se aksesit në veprimtarinë gjyqësore është një përjashtim dhe jo rregull. Kjo reflektohet në të gjitha pikat e draftit. Që me krijimin e gjykatave, ato u krijuan me idenë e të qenit publike. Vetë emri i tyre sugjeron fjalën “oborr”, pra gjyqet në vende të hapura. Ky parim është trupëzuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 146, pika 2 e cila sanksionon detyrimin pozitiv që:

“Vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast”.

Të njëjtin qëndrim mban edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ku në një gjykim të fundit, lidhur me çështjen *Dadasbeyli kundër Azerbajxhan* (3 dhjetor 2020), ku palë e tretë është edhe qendra Res Publica, thekson se:

“...zhvillimi i seancave publike mbron parimin themelor të nenit 6§1. Karakteri publik i procedimit mbron palët ndërgjyqëse kundër administrimit të drejtësisë në fshehtësi, pa vëzhgim publik është gjithashtu një nga mjetet me të cilat mund të ruhet besimi në gjyqësor. Administrimi i drejtësisë në publik i jep asaj legjitimitet. Duke e bërë administrimin e drejtësisë transparente, publiciteti kontribuon në përmbushjen e qëllimit të nenit 6§1, përkatësisht një gjykim të drejtë, garantimi i të cilit është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike, Brenda kuptimit të Konventës (shih Boshkoski k. Maqedonia e Veriut, nr. 71034/13, § 39, 4 qershor 2020, për referenca të mëtejshme). Ekziston një

pritshmëri e lartë për publicitet në procedurat e zakonshme penale, të cilat mund të shqetësojnë individë të rrezikshëm...." (paragrafi 24)

GJEDNJ është shprehur edhe se disa vende, të cilët e kanë parimisht jo të hapur veprimtarinë gjyqësore, mund të vijnë të publikojnë vendimet me anonimizim. Por, në listën e këtyre vendeve që kanë pranuar këtë parim të kundërt nuk bën pjesë Shqipëria.

b. Draf i jep administratës gjyqësore kompetenca që duhet t'i ketë gjyqtari (sipas kodeve të procedurave)

Kodet e procedurave, në frymën e parimit të sipërcituar, përmes dispozitave procedurale që rregullojnë seancën me dyer të mbyllura, kanë rregulluar ato raste kur përjashtimisht duhet të sakrifikohet transparenca me qëllim mbrojtjen e privatësisë apo të dhënave të ndjeshme. Për këto raste ligjvënësi i ka lënë detyrë dhe diskrecion gjyqtarit, i cili për shkak të njohjes me detajet e çështjes ka mundësinë të vlerësojë nëse duhet të "sakrifikohet" transparenca apo jo. Duke ia kaluar një kompetencë të tillë zyrtarëve të tjerë të administratës gjyqësore, krijohet një ndërhyrje në diskrecionin e gjyqtarit.

c. Draf pengon avokatët, gazetarët dhe studiuesit në ushtrimin e funksioneve të tyre

Drafti parashikon rastet përjashtimore të aksesit të plotë në vendime dhe dosje gjyqësore. Në këtë kategori, përveç palëve dhe mbrojtësve të tyre renditen edhe personat që për arsye studimi, shkencore, statistikore mund të kenë akses. Fillimisht theksojmë nevojën që në këtë pikë duhet të përfshihet edhe gazetari si profesionisti që informacionin e marrë gjatë aksesit në dosje dhe vendime gjyqësore e kërkon për interes publik. Kujtojmë këtu se gazetari mund të bëhet vetë mbajtës dhe mbrojtës i të dhënave personale (kontrollues i të dhënave), pikërisht për të garantuar anonimitetin në rastin eventual, duke pasur mundësi të mos cenohet interesi publik (përmes aksesit në dosje nga ana e tij).

Drafti liston të drejtën për akses në dosje të avokatëve që janë përfaqësues të palëve në çështje, por përjashton të drejtën për informim të avokatëve të tjerë që kanë interesa të lidhura me çështjen. Aksesit i avokatëve në përgjithësi në çdo dosje gjyqësore, edhe kur nuk është palë vetë, është e domosdoshme për të rritur efencën dhe profesionalizimin në punën e tij dhe mbrojtjen e të drejtave të palëve që përfaqëson. Një avokati i duhet të marrë një provë e cila gjendet në një dosje tjetër gjyqësore ku klienti i vet nuk është palë (për shembull në një vendim për masë arresti kur vlerësimi i masës është i lidhur me një dosje tjetër). Një avokati i duhet të këshillojë klientin e vet nëse duhet të ndërhyjë në një proces gjyqësor që zhvillohet mes palëve të tjera (ndërhyrja kryesore apo dytësore sipas neneve 189-191 të Kodit të Procedurës Civile), të cilat ai dhe pala që përfaqëson nuk ka si të ushtrojë këtë të drejtë nëse nuk ka akses në informacion, etj.

Sistemi jonë ligjor në shumë aspekte ka rudimente të një sistemi inkuizitor (në kuptimin procedural penal) ku avokati ka një rol të reduktuar në hetimin për interesa të klientit të tij. Në shumë vende të Evropës, avokati nuk kufizohet në akses në informacion, edhe në rastin e të dhënave sensitive si të dhënat bankare, hipotekore, apo të dhëna kontraktuale të tjera, pikërisht për të realizuar më mirë mbrojtjen e interesave të ligjshme të palëve që përfaqëson. Garancia që mund të shoqërojë këtë të drejtë të avokatëve është që ata mund të konsiderohet si kontrollues të të dhënave, me pasojë detyrimin për të mos publikuar të dhëna jashtë ushtrimit të të drejtave procedurale dhe të themelit të palëve që përfaqëson.

7. TË DHËNA NGA PLATFORMA PUBLEAKS.AL

Platforma Puleaks.al nisi funksionimin në dhjetor të vitit 2016 për të lehtësuar përdorimin e ligjit për të drejtën e informimit për çdo qytetar që ka kuriozitetin dhe angazhimin publik për të marrë informacion rreth veprimtarisë shtetërore. Puleaks.al përmban disa rubrika, si ajo e aplikimit të pyetjeve, ajo e gjurmimit të ecursisë së kërkesës, ajo e programeve të transparencës, etj. Një rubrikë e veçantë është edhe ajo që përmban udhëzime dhe studime në këtë fushë.

Gjatë këtyre 5 viteve Puleaks.al është pasuruar me shumë informacione të publikuara, duke numëruar afro 2000 informacione dhe dokumente zyrtare të publikuara në format lehtësisht të aksesueshëm nga publiku.


Pavarësisht se ky nuk është objekti kryesor i këtij raporti, Res Publica vazhdon ta shohë me interes vëzhgimin mbi të dhënat rreth aplikantëve. Këto të dhëna mbledhen në momentin e aplikimit online. Jo të gjithë aplikantët dëshirojnë të ndajnë me stafin tonë të dhënat e tyre dhe në këto raste është respektuar e drejta për të mbetur anonim. Gjithsesi, edhe të dhënat e personave që kanë dëshiruar t'i ndajnë të dhënat e tyre, mbahen nga Res Publica dhe përdoren vetëm për qëllime studimore, si ai që paraqitet në vijim, pa evidentuar emra të veçantë aplikantësh. Res Publica ka përpunuar të dhëna nga aplikimet për indikatorët e mëposhtëm:

- përdorimi i Puleaks.al
- objekti i informacionit të kërkuar
- autoritetet publike të cilëve u drejtohet kërkesa
- arsimit i aplikuesve
- mosha e aplikuesve
- gjinia e aplikuesve

Indikatorët e mësipërm ndihmojnë për të kuptuar se cili është lloji më i zakonshëm i informacionit të kërkuar, cili grup është më i interesuar dhe kërkon të njihet me veprimtarinë e institucioneve, si paraqitet niveli i njohjes së ligjit në grupe të caktuar, etj.

7.1. Përdorimi i faqes Publeaks.al

Në vijim jepen disa të dhëna lidhur me përdorimin e faqes Publeaks.al:




Nga grafiku i mësipërm vihet re se interes më të madh për të vizituar platformën ka pasur në muajin Janar 2021, ndërsa ka pasur më pak interes në Gusht 2021.

Vihet re gjithashtu një rritje interesi që ka nisur prej muajit Korrik 2020 e deri në fund të Prillit 2021, kohë e cila korespondon me periudhën e nxehtë të para zgjedhjeve parlamentare të 25 Prillit 2021. Pas konfirmimit të fituesit të zgjedhjeve, ka ardhur një relaksim i aktiviteteve të gazetarisë, të cilat dukshëm ishin më të shtuara në momenti para zgjedhjeve, kur edhe ndikimi i medias është më i lartë. Për pasojë edhe përdorimi i platformës Publeaks.al reflekton këtë trend.

Ndonëse, relaksimi i pas zgjedhjeve nuk është një dukuri pozitive, sepse media dhe shoqëria civile nevojiten të jenë në alert gjatë gjithë kohës për të përmbushur rolin e tyre në një shoqëri demokratike, vlen të shihet me sy pozitiv fakti që gazetarët dhe aktivistët kanë përdorur dokumentat zyrtare për të mbështetur faktet e cituar në shkrimet e tyre. Ky është një element kyç i gazetarisë etike dhe të përgjegjshme.


7.2. Aplikantët sipas grupmoshave

Nga të dhënat e mbledhura nga publeaks.al, konstatojmë që subjektet që i janë drejtuar publeaks.al i përkasin të gjitha grup moshave.



Grup mosha më e interesuar për të marrë informacione gjatë vitit 2021, rezulton të jetë ajo mes 20-30 vjeç. Kjo shifër është e ngjashme me atë të vitit 2020. Ndërkohë nuk ka pasur kërkesa nga grupmosha mbi 50 vjeç, ndryshe nga vitet e kaluar.


7.3. Aplikantët sipas arsimimit



Nga të dhënat konstatohet se grupi më i interesuar për të marrë informacione vazhdon të jetë ai me arsim të lartë. Vihet re një rënie interesi nga personat me arsim të mesëm në krahasim me vitet e kaluar.

7.4. Aplikantët/et sipas gjinisë

Raporti i aplikantëve meshkuj dhe femra për vitin 2021 paraqitet si më poshtë:



Përsa i përket gjinisë së aplikuesve, edhe këtë vit kemi një interes pothuajse të barabartë mes dy gjinive, me një diferencë prej 6 % më shumë femra, ndryshe nga vitet e kaluar ku interesi më i madh është shfaqur nga meshkujt. Gjithsesi, ky fakt i vënë re në platformën Publeaks nuk mund të konsiderohet si një fenomen gjithëpërfshirës përsa i përket interesit për të përdorur të drejtën e informimit.

8. KONKLUZIONE

Si konkluzion të përmbledhur mund të themi se niveli i zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit edhe në vitin e 7-të të monitoruar mbetet larg realizimit të qëllimit të ligjvënësit dhe larg pritshmërive të ngritura, kur ky ligj hyri në fuqi në vitin 2014.

Përdorimi i këtij ligji bëhet për arsye të ndryshme, nga kërkues të ndryshëm. Për shembull gazetarët e shfrytëzojnë ligjin për të marrë informacione me qëllim hartimin e raportimeve, investigimeve dhe analizave të tyre. Për këtë arsye gazetarët kanë nevojë të aksesojnë shpejt dhe plotësisht dokumentet e kërkuara, përndryshe ata nuk do të mund të sjellin lajmet në kohën e duhur para një publiku të interesuar mbi zhvillimet e fundit. Aktivistët e shoqërisë civile e përdorin ligjin për të mbështetur aktivitetet e tyre të cilat shpesh kërkojnë planifikim dhe organizim të mirë. Edhe këta kërkues kanë nevojë të kenë siguri për të marrë informacionet në kohën dhe mënyrën e duhur. Qytetarë të tjerë kanë interes të sigurojnë dokumenta për t'i përdorur në çështje gjyqësore, administrative, etj, të cilat janë dinamike dhe nuk lënë shumë kohë për të pritur marrjen e informacioneve. Për shembull, nëse një person është palë e paditur në një gjyq, ai ka vetëm 30 ditë kohë që të përgatisë mbrojtjen e tij dhe nëse dokumentat e kërkuara nuk aksesohen plotësisht brenda këtij afati, atëherë afektohet e gjithë procedura gjyqësore në dëm të tij. Sigurisht që në morinë e përdoruesve të ligjit për të drejtën e informimit, gjenden edhe persona që kërkojnë informacione për të shuar kureshtjen e tyre, dhe mbase kjo kategori është më e duruar në pritjen e përmbushjes së kërkesave, por gjithsesi edhe kjo kategori ka nevojë të aksesojë informacionet brenda kohës kur interesi i tyre për një çështje është ende i lartë.

Në këtë kuptim, fokusi ynë është vënë te pjesa operative që siguron ligji, pra sa është i aftë ky ligj dhe struktura që kujdeset për zbatimin e tij, që të sigurojë aksesimin e informacionit nga publiku, plotësisht dhe në kohën e duhur. Pjesa tjetër, që ka të bëjë me cilësinë e debateve juridike të shtruara para Komisionerit për të Drejtën e Informimit, apo para gjykatave, ndonëse ka rëndësinë e vet për të ardhmen, ka një rëndësi dytësore në raport me operativitetin.

Gjetjet e këtij studimi japin një tablo problematike të zbatimit të ligjit, e cila paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

8.1. Për sa i përket reagimit ndaj kërkesave për informacion

- Vetëm 60% e kërkesave marrin një përgjigje të plotë pas kërkesës fillestare. Gjithashtu 17% marrin përgjigje të pjesshme (përgjigje "pa përgjigje"), ndërsa 23% nuk marrin asnjë përgjigje.
- Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare është rritur mjaft ndjeshëm në vitin 2021, në gjithsej 27 ditë kalendarike, duke kaluar edhe kohëzgjatjen mesatare në vitin 2013 kur në fuqi ishte ligji i vjetër, ka qenë 24 ditë kalendarike (sipas një monitorimi të Res Publica në atë kohë).
- Ndonëse në 88% të rasteve merret një përgjigje pas ankimit, kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes është rritur ndjeshëm krahasuar me vitin që lamë pas, duke arritur në 20 ditë kalendarike.
- Në një pjesë të vogël të kërkesave, por të rëndësishme sepse kanë trajtuar informacione që zakonisht refuzohen pa të drejtë nga administrata, si kontratat e prokurimit, koncensionet, etj., autoritetet nuk japin përgjigje as pas vendimit të Komisionerit dhe as pas vendimit të gjykatës.

Reagimi ndaj kërkesave për informacion është njëloj si në vitet e mëparshme. Viti 2021 paraqet një përkeqësim të lehtë të disa parametrave kryesorë. Përgjigjet nuk jepen në kohën e duhur. Në çerekun e rasteve, përveç humbjes së madhe kohore është vijuar me ankime administrative dhe në disa raste edhe gjyqësore. Informacionet më sensitivë nuk aksesohen, deri në pikën që e humbin vlerën. Megjithëse ligji i vitit 2014 i shkurtoi afatet ndjeshëm, situata është njëloj me atë përpara këtij ligji. Pra, sjellja e autoriteteve publike në kuptim të operativitetit është e njëjtë dhe e pandikuar nga ligji i ri dhe strukturat e reja që kujdesen për zbatimin e ligjit. Në një pjesë të rasteve vijon të përdoret truku i dhënies së përgjigjeve të pjesshme dhe evazive. Komisioneri për të Drejtën e Informimit vijon të marrë shumë kohë për të trajtuar rastet, duke tejkaluar shpesh afatet ligjore, dhe trajtimi i ankesave nga ana e tij nuk ka mjaftuar për të siguruar informacione të rëndësishme në të gjitha rastet. Autoritetet që nuk duan të publikojnë informacionet janë të pajisur me shumë mjete juridike për të zvarritur dhënien e informacionit pa fund. Informacionet e tjerë, ato që aksesohen më lehtë por përsëri shpesh jashtë standardeve ligjore, janë zakonisht informacione që nuk hedhin dritë mbi veprimtari të rëndësishme shtetërore.

8.2. Për sa i përket programeve të transparencës

- Asnjë institucion nga 100 të monitoruar, nuk e ka përmbushur plotësisht programin e transparencës.
- Vetëm 1/4 e autoriteteve kanë përmbushur gjysmën ose më shumë të kërkesave të ligjit për këto programe.
- 60% e autoriteteve të monitoruara kanë informacione të reduktuara dhe shpesh herë të parëndësishme në programin e transparencës.
- 1/7 e autoriteteve nuk kanë fare një program transparence dhe disa prej tyre nuk kanë as faqe interneti.

Në kushtet kur 100 autoritetet e përzgjedhura për monitorim janë më të rëndësishmit në vend (institucionet kushtetuese, ministrinë, drejtorinë më të rëndësishme, bashkitë më të mëdha dhe gjykatat e prokurorisë e rrethet më të mëdha), është e papranueshme që asnjë prej tyre nuk ka përmbytur tërësisht kërkesat e ligjit. Njëlloj është e papranueshme që pjesa dërmuese e tyre kanë përmbytur pak ose aspak kërkesat e ligjit. Në shumë raste vihen re programe me informacione të vjetruara dhe pa vlerë. Situata vijon në një nivel shumë të ulët, duke përmbytur në mesatare vetëm 38% të kërkesave të ligjit, e cila ndonëse është më mirë vitin e kaluar (25%), nuk vihen re shenja serioze shprese se e ardhmja do të jetë ndryshe pa një plan masash energjik. Në këtë kuptim, risia ligjore e “programeve të transparencës” mund të vijohet të konsiderohet si e dështuar. Qytetarët nuk mund të sigurojnë informacione të vlefshme me lehtësinë e një kliku, por do u duhet të bëjnë kërkesa për informacion, njëlloj si në kohën para miratimit të ligjit të ri.

8.3. Për sa i përket infrastrukturës për zbatimin e ligjit

- Ende disa autoritete të rëndësishme nuk kanë caktuar një koordinator për të drejtën e informimit, ose nuk ka bërë publike të dhënat e tij.
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve është plotësuar nga vetëm 1/8 e autoriteteve.
- 1/4 e autoriteteve nuk kanë fare regjistër, ose e kanë atë tërësisht pa informacione.

Me plotësimin e kërkesave të ligjit vetëm nga 1/8 e autoriteteve publike më të rëndësishme, mund të thuhet se edhe kjo risi e ligjit pothuasje ka dështuar. Fakti që një pjesë e rëndësishme e autoriteteve nuk marrin mundimin as të publikojnë një regjistër sa për sy e faqe, tregon për mungesën e theksuar të seriozitetit në trajtimin e këtij aspekti të rëndësishëm. Në këto kushte, asnjë qytetar nuk e përdor dot regjistrin për të marrë një informacion që është kërkuar nga dikush tjetër më herët, por do t'i duhet të bëjë një kërkesë të re, njëlloj siç ndodhte para miratimit të ligjit të ri.

8.4. Për sa i përket veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit

- Numri i ankesave të paraqitura para Komisionerit në vitin 2021 është më i larti në të gjitha periudhat.
- Ndërkohë, Komisioneri ka marrë vendim vetëm për afro 4% të rasteve gjatë vitit 2021, duke vijuar të shënojë një shifër tepër të ulët.
- Komisioneri ka respektuar afatet ligjore në 27% të rasteve. Pjesa tjetër është trajtuar në tejkalim të afatit 15 ditor. Kohëzgjatja mesatare e vendimmarrjes së Komisionerit ka shënuar një mesatare prej 32 ditësh.
- Cilësia e vendimeve të Komisionerit është e mirë, njëlloj si në vitet e kaluara, dhe vjen si rezultat i hetimeve të plota. Ato përmbyjnë një analizë të mirë të balancës midis të drejtave që konfliktojnë me atë të informimit, duke çmuar këtë të fundit vazhdimisht. Debat i juridik te Komisioneri është paraqitur serioz dhe palëve u është dhënë mundësia të shprehen dhe të dëgjohen.

- Sanksionet e aplikuara janë shumë të pakta dhe të rralla, me vetëm 2 të tilla gjatë gjithë vitit 2021 (në lidhje me ankesat për refuzim informacioni), në mospërputhje me gjendjen problematike që paraqitet në këtë vite.
- Janë aplikuar sanksione për mosplotësim të programit të transparencës, gjithsej në 6 raste, duke shtuar ndjeshëm presionin për këtë aspekt të ligjit, ndryshe nga vitet e kaluar.

Njëlloj si në periudhat e mëparshme, Komisioneri vijon të marrë shumë pak vendime në raport me ankesat e mbërritura te kjo zyrë. Gjatë vitit 2021, vetëm 4% e rasteve janë trajtuar me vendim, ndërkohë që raportimi i Komisionerit për çështjet e tjera është që janë zgjidhur me mirëkuptim, duke "iu vënë në dispozicion informacioni ankuesit". Pavarësisht se çfarë pretendon Komisioneri, shumë gazetarë ankohen pranë stafit të qendrës Res Publica se nuk i aksesojnë shumë prej këtyre informacioneve.

Niveli i sanksioneve është më i lartë se në vitet e kaluar, por ende shumë i ulët. Vihet re një lidhje e drejtpërdrejtë mes sanksioneve me gjobë në 6 raste për programet e transparencës dhe përmirësimit të programeve të transparencës nga 25% në 38% brenda një viti. Dukshëm, sanksionet funksionojnë për ndërgjegjësimin e organeve publike që kanë injoruar me vite kërkesat e ligjit. Përmirësimin e programeve të transparencës mund të ndikojë në uljet e fluksit të kërkesave dhe ankesave, me pasojë organizimin më të mirë të punës së vetë Komisionerit.

Ndonëse ka një rritje të vendimmarrjes, ajo rezulton e ngadalësuar në krahasim me dy vitet e fundit.

8.5. Përsa i përket çështjeve të veçanta

- Vijon të pengohet publikimi i seancave dhe vendimeve gjyqësore. Komisioneri ka ndërmarrë nismën për të draftuar një Udhëzim të ri, i cili synon anonimizimin e vendimeve gjyqësore, në kundërshtim me frymën e Kushtetutës, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke mos ia lënë këtë kompetencë vetë gjykatave për të anonimizuar rast pas rasti të dhënat, duke e vendosur anonimizimin si rregull standard dhe publikimin si përjashtim.
- Vijon moszbatimi pa shkak i vendimeve të Komisionerit, edhe kur këto vendime nuk janë ankimuar në rrugë gjyqësore nga autoritetet. Vijon sjellja e disa autoriteteve që shfrytëzojnë të gjithë mjetet procedurale për të mos dhënë informacione sensitive që hedhin dritë mbi veprime të dyshuara si korruptive.
- Vijon të ketë një paqartësi për tarifat e aplikueshme për marrjen e informacioneve (në raste të shkëputura) ku mungesa e një praktike unifikuese nga Komisioneri ka sjellë edhe raste abuzive ku kërkuarit të informacionit publik i kërkohet të parapaguajë shuma edhe deri në 300 mijë lekë për marrjen e këtij informacioni.
- Vijon të mbeten të paadresuara çështjet problematike të ligjit të evidentuara dhe nga raportet e përvitshme të tilla si për shembull përfshirja e padive për të drejtën e informimit në ato padi për të cilat merret vendimi që në shkallë të parë. Konventa e Tromsø që sapo u ratifikua nga Shqipëria, kërkon procedura të shpejta gjyqësore, si dhe Komisioneri

është organ quasi gjyqësor, që do të thotë se Gjykata Administrative në këtë rast vepron si “instancë apeli” dhe nuk ka nevojë edhe për Gjykatën Administrative të Apelit (njëlloj si rasti i gjobave me vlerë të vogël, për të cilat ka gjithmonë një organ apelimi quasi gjyqësor).

- Përpjekjet për të përmirësuar aspekte të ligjit për të drejtën e informimit nëpërmjet draftit të hartuar nga Zyra e Komisionerit vlerësohen pozitive, por do të ishte e rekomandueshme marrja parasysh e rekomandimeve të ofruara nga organizatat e shoqërisë civile dhe gazetarët në përmirësimin e këtij drafti, si përdoruesit më të zakonshëm të këtij ligji dhe për pasojë edhe njohës të mirë të defekteve të tij.
- Krijimi i Agjencisë për Media dhe Informim rrezikon të krijojë konfuzion përmes strukturave aktuale që funksionojnë në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit dhe kësaj agjencie e cila synon centralizimin e komunikimit të qeverisë me publikun. Konfuzioni mund të pasohet me mbivendosje funksionesh deri në pikën që të cenohet e drejta për informim.

Të gjitha këto, tregojnë edhe një herë nevojën për reflektim të mëtijshëm lidhur me problematika të cilat mbeten ende të paadresuara nga draft-amendamenti i hartuar së fundmi.

Kujdes i veçantë duhet treguar me vëmendjen ndaj Agjencisë për Media dhe Informim, e cila, nëse rezulton që shqetësimet e gazetarëve do të vërtetohen në praktikë, duhet vlerësuar mundësia për goditjen e bazës ligjore të kësaj agjencie në gjykatën kompetente. Aktualisht ka të dhëna të mjaftueshme për të kuptuar se shqetësimi i gazetarëve është i mbështetur dhe serioz. Në pamje të parë, një qeveri ka të drejtë të përqendrojë dhe koordinojë propagandën e vet, por kjo nuk duhet të interferojë me të drejtën e gazetarëve për t'u informuar.

8.6. Për sa i përket interesit të qytetarëve për të përdorur të drejtën e informimit

- Ka pasur një rritje interesi para zgjedhjeve të përgjithshme të 25 Prillit 2021.
- Interesi i qytetarëve të zakonshëm është rritur gjatë vitit 2021.
- Vijnë të tregohet interes më i lartë nga persona me arsim të lartë ku një pjesë të konsiderueshme e zënë individët me arsim të lartë Master.
- Ka një rritje të interesit nga grumoshat 20 deri 30 vjeç dhe rënie të interesit nga grupmoshat mbi 50 vjeç.
- Nuk shfaqen dallime thelbësore midis gjinive.

Edukimi ndikon drejtpërdrejt te personat më të interesuar për të përdorur ligjin për të drejtën e informimit. Ndërsa faktori moshë është i luhatshëm sipas rastit. Shpesh shfaqet interes nga moshat e reja e shpesh nga moshat e maturuara, në varësi të zhvillimeve politike në vend.

9. REKOMANDIME

Nisur nga konkluzionet e mësipërme dhe në vijim të monitorimeve të vazhdueshme që nga vitet e kaluara, rekomandojmë sa vijon:

Rekomandimi nr. 1

Përpara hartimit dhe miratimit të Rezolutës për Vlerësimin e Punës së Komisionerit, Kuvendi i Shqipërisë të informohet edhe nga organizatat e medias ato të shoqërisë civile

Në kushtet kur vihet re se nga njëra anë veprimtaria e zyrës së Komisionerit rezulton të jetë e kritikueshme dhe jo në parametrat e duhur, se kjo zyrë nuk merr masa të mjaftueshme për të zbatuar plotësisht rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë në Rezolutat e përvitshme dhe nga ana tjetër këto rezoluta, përkundrazi, japin vlerësime për punën e Komisionerit në mënyrë krejt formale dhe të pambështetura në vlerësime objektive, pa prezantuar problematikat, rekomandojmë që Kuvendi dhe komisionet e tij të marrin parasysh, përveç raporteve të Komisionerit, edhe raporte të bëra nga organizatat, si dhe rekomandojmë që ato të ftohen të marrin pjesë në seancat dëgjimore të prezantimit dhe vlerësimit të punës së Komisionerit për të Drejtën e informimit. Madje këto organizata duhet të ftohen të japin vlerësime me shkrim lidhur me aktivitetin e Komisionerit.

Rekomandimi nr. 2

Komisioneri për të Drejtën e Informimit duhet të marrë vendim për çdo ankese, duke shmangur “zgjidhjet me ndërmjetësim” dhe/ose refuzimet mes shkresave të nëpunësve të tij pa delegim kompetence

Në disa vendime gjykatë ku janë vënë në diskutim shkresat e nëpunësve të zyrës së Komisionerit, është theksuar, përsëritur dhe ndonjëherë shpallur të pavlefshme juridikisht

shkresat me të cilat nëpunësit e zyrës së Komisionerit u përgjigjen ankesave. Në këto kushte Komisioneri për të Drejtën e Informimit duhet të bëjë pjesë të praktikës së vet përgjigjen e ankimeve me vendim, si e vetmja formë që i njeh ligji për shprehjen e vullnetit. Çdo formë tjetër e ekspozon atë ndaj paligjshmërisë përveçse prodhon dhe efekte negative në garantimin e të drejtës për informim, si dhe shtrembëronjë realitetin duke pasqyruar shifra të dyshimta.

Rekomandimi nr. 3

Të zbatohen më shumë sanksione në rrethanat e justifikuara, sidomos në rastet e përsëritësve dhe në raste të tjera flagrante

Në kushtet kur shohim që ligji për të drejtën e informimit nuk respektohet në mënyrë masive dhe pothuaj rregullisht, duhen gjetur strategji të reja përveç pritjes për të besuar se dikur do të ndërgjegjësohet administrata. Një shembull i mirë se si bëhet që ligji të respektohet kur ai shkelet rregullisht, për shkak të mungesës së kulturës, vullnetit etj. është ligji kundër duhanit. Ai ligj u zbatua vetëm pas një fushate të mirëfilltë sanksionesh. Rast suksesi nga i cili duhen nxjerrë leksione, nëse mungon vullneti për të respektuar ligjin në mënyrë të përsëritur. Në këtë kuptim rekomandojmë që Komisioneri të nisë me aplikimin e sanksioneve në formë fushate, duke e nisur me paralajmërime e duke shkuar te gjrobat, për ato rastet që janë flagrante kur refuzimi i informacionit bëhet për shkaqe neglizhence, mungese dëshire për të bërë transparencë, kundër një vendimeve të Komisionerit, etj.

Rekomandimi nr. 4

Nevojitet të rishikohet draft Udhëzimi me qëllim rregullimin e anonimizimit të të dhënave në gjykata

Përsërisim në këtë raport të njëjtin rekomandim të mëparshëm, për draft udhëzimin e ri për anonimizimin e vendimeve gjyqësore. Udhëzimi aktual për anonimizimin e të dhënave në gjykata, si dhe drafti i ri, janë në të njëjtën frymë, atë të krijimit të kufizimit si rregull, dhe publikimit si përjashtim. Nevojitet që qasja të jetë në frymën e kundërt, atë të publikimit si rregull, dhe të anonimizimit si përjashtim, si dhe për t'ia lënë këtë kompetencë gjykatave, siç përcakton Kushtetuta, kodet dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rekomandimi nr. 5

Të përshtatet modeli i programit të transparencë për natyra të ndryshme të autoriteteve publike me fokus të veçantë publikimin e informacioneve për veprimtari me impakt në mjedis

Modeli i transparencës nuk është i përshtatshëm për të gjithë autoritetet publike, duke paralajmëruar vështirësi në zbatimin e tij, por edhe në përdorimin nga qytetarët. Meqenëse problematika e informacioneve për veprimtaritë me impakt në mjedis paraqet një rëndësi të veçantë, rekomandojmë që të vazhdojnë përpjeket e Komisionerit për implementimin e një modeli që përfshin këto informacione në mënyrë eksplicite.

Rekomandimi nr. 6

Të parashikohet në ligj mundësia për të ekzekutuar forcërisht vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit

Në mënyrë të përsëritur, rekomandojmë përfshirjen në projektligjin e hartuar së fundmi për ligjin “Për të drejtën e informimit” e mundësisë që vendimet e Komisionerit të jenë tituj ekzekutivë dhe mos ekzekutimi i tyre të përbëjë shkelje administrative.

Rekomandimi nr. 7

Për paditë me objekt kërkim informacioni, vendimi i gjykatës duhet të marrë formë të prerë që në shkallë të parë

Në mënyrë të përsëritur, rekomandojmë që në ligjin nr.49/2012, një nga llojet e padive për të cilat vendimi i gjykatës merr formë të prerë që në shkallën e parë të gjykimit të jenë edhe ato me objekt kërkimin e informacionit. Siç e kemi thënë edhe në studimet e mëparshme, përpara dërgimit të çështjes në gjykatë Komisioneri garanton një procedurë quasi gjyqësore dhe mbyllja e mundësisë së ankimit në një gjykatë më të lartë pas asaj të shkallës së parë nuk është shkelje e procesit të rregullt ligjor sipas standardeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo ndërhyrje ligjore do të përmbushte edhe një prej standardeve kryesore të Konventës së Tromsot, e cila aktualisht është në procedurë ratifikimi nga Republika e Shqipërisë.

Rekomandimi nr. 8

Rekomandohet të rishikohet kohëzgjatja e mandatit dhe mënyra e emërimit të Komisionerit Ligji i jep Komisionerit një mandat 5 vjeçar dhe ai emërohet nga Kuvendi

Në kushtet kur Kuvendi dominohet nga e njëjta forcë politike që më pas dominon edhe autoritetet publike që do të mbikqyren nga Komisioneri, është e rëndësishme që ky i fundit të ketë fuqinë e duhur për të përballuar presionin e natyrshëm politik. Kështu, përveç zgjatjes së mandatit, nevojitet të rishikohet edhe skema e emërimit të Komisionerit, duke përfshirë në këtë skemë elementë kufizues të pushtetit politik dhe futjen e elementëve të pavarur, si për shembull propozimi të vijë nga universitetet, organizatat e mediave, apo shoqëria civile dhe shkarkimi të bëhet vetëm me propozim të tyre, përveç rasteve kur ka një shkelje të rëndë të ligjit apo arsye të tjera të përligjura dhe të pashmangshme, si dorëheqja, etj.

Rekomandimi nr. 9

Rekomandohet të rishikohet kostoja e riprodhimit të dokumentave zyrtarë

Ligji përcakton parimin se informacioni jepet falas. Në raste të veçanta, ligji i lejon autoritetet publike që të kërkojnë rimbursim të kostos së riprodhimit të informacionit. Kostoja është vetëm ajo që ka të bëjë me kostot materiale dhe jo me shërbimin e kryer nga punonjësit e

autoriteteve publike. Aktualisht Komisioneri ka lejuar aplikimin e “tarifave”, të cilat nuk përbëhen vetëm nga kostoja dhe për më tepër, në disa raste tarifat janë më të larta se kostoja e fotokopjimit në tregun e lirë, e cila është çmim shitjeje. Nevojitet të rishikohet ky aspekt, në mënyrë që të shmangen pengesat abuzive në aksesin në informacion. Gjithashtu, Komisioneri duhet të kujdeset që institucionet të ofrojnë sa më shumë që të jetë e mundur, sipas kërkesës së vetë subjekteve kërkuar, dokumentat e skanuar dhe dërguar në rrugë elektronike, të cilat duhet të ofrohen pa pagesë, edhe nëse janë voluminoze.

Rekomandim nr. 10

Rekomandohet që gazetarët të përdorin “gjqqtarët e medias” për të aksesuar shpejt informacione të proceseve gjyqësore

“Gjqqtarët e medias” janë një koncept i ri, i përfshirë pas vitit 2017 dhe aktualisht janë verifikuar raste suksesi të cilët janë premtues për një praktikë të mirë. Vendimet merren në një kohë të shpejtë dhe janë lehtësisht të kërkueshëm duke kontaktuar me gjyqtarët e medias.

Rekomandimi nr. 11

Rekomandohet depozitimi i Deklaratës te Sekretariati i Konventës së Këshillit të Evropës Mbi Aksesin në Dokumente Zyrtare, sipas së cilës Republika e Shqipërisë njeh si autoritete publike për efekt të ligjit edhe autoritetet ligjvënëse, gjyqësore, etj,

Rekomandohet që Shqipëria ti drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm i Këshillit të Evropës me deklaratë (neni 21 i Konventës). Vlen të theksohet se ligji aktual Shqiptar i përkufizon si autoritete publike autoritetet gjyqësore, ndërsa në ndryshimet e propozuara veprimtaria e organeve gjyqësore kufizohet, gjë e cila është e kritikueshme dhe mbetet për tu rivlerësuar gjatë përpunimit të draftit të projektligjit.

Rekomandimi nr. 12

Rekomandohet që ligji të përfshijë edhe përkufizime të qarta të dëmit që shkaktohet nga mosrespektimi i të drejtës për t’u informuar, si dhe mënyrat e matjes së dëmit

Rekomandohet që në ndryshimet e pritshme të ligjit për të drejtën e informimit, të përfshihen përkufizime dhe mekanizma të qartë që mundësojnë dhënien e dëmshpërblimeve në rast të mosrespektimit të së drejtës për informim. Ligji duhet të përmbajë kritere të matshme të kuantifikimit të dëmit, që personi përgjegjës i detyrohet kërkuar, i cili është edhe i dëmtuari në këtë kuptim, në mënyrë të ngjashme me nenin 647/a të Kodit Civil.


* * *

Tiranë, Mars 2022

Qendra “Res Publica”
“E drejta e informimit 2021 -
Transparenca është e thjeshtë,
deri sa autoritetet e komplikojnë “për mirë””
Mbështetur nga:
National Endowment for Democracy
Tiranë, Mars 2022
48 faqe
Formati: 21 x 29.7 cm
Tirazhi 200 kopje



www.publeaks.al
www.respublica.org.al



© Res Publica 2022

